



Advocacy Training & Resource Center



Security Policy Research Center



Kosovo Center for Business Support



Me Demokraci Pjesëmarrëse për një Kosovë pa Radikalizim

Projekti “Me Demokraci Pjesëmarrëse për një Kosovë pa Radikalizim” është një Konsorcium i udhëhequr nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC) dhe e zbatuar në partneritet me, Kosovar Institutefor Policy Research and Development (KIPRED), Balkan Investigative Reporting Network (BIRN), Security Policy Research Center (SPRC), Kosovo Center for Business Support (KCBS) dhe Democracy+ (D+).

Misioni dhe Vizioni i Konsorciumit

Misioni i Konsorciumit është të promovojë angazhim dhe aktivizëm në ndërtimin e një komuniteti me aftësi rezistuese, dhe të kontribuojë drejt zvogëlimit të motivimeve dhe nxitjeve për radikalizëm që mund të shpien në ekstremizëm të dhunshëm. Kjo do të arrihet duke kanalizuar diskutimin publik drejt ndërtimit të aftësisë rezistuese, ngritjes së llogaridhënies tek institucionet publike dhe qeveritare (lokale dhe kombëtare), kapacitetet e tyre për fuqizimin e rinisë, dhe formësimin e ambientit shoqëror dhe qeveritar. Aktivitetet e programit të Konsorciumit janë të dizajnuara për të ndikuar pozitivisht tek ambienti i grupit të popullatës duke ndryshuar mendimet dhe sjelljet e rëndomta institucionale dhe shoqërore.

Strategjia e Konsorciumit për Intervenim

Strategjia e Konsorciumit për intervenim përfshinë komponentët vijues:

- Krijimi i një rrëfimi publik për kuptim të përmirësuar dhe ndryshimin e perceptimeve dhe qëndrimeve të komunitetit drejt të kthyerve, të burgosurve dhe familjeve të tyre, që trajton gjithashtu marginalizimin e perceptuar dhe diskriminimin shoqëror dhe padrejtësinë, në mënyrë që komuniteti i përgjithshëm të krijoj rrethana të pranueshme për përfshirje shoqërore të këtij grupi shoqëror,
- Ndërtimi i aftësisë rezistuese përmes ofrimit të mundësive për mbështetje shoqërore dhe përfshirje në tregun e punës përmes përmirësimit të shkathtësive ndërmarrëse të anëtarëve të caktuar të familjes, duke mos ju zbuluar në mënyrë të drejtpërdrejt atyre dhe publikut karakterin e Parandalimit të Ekstremizmit të Dhunshëm (PEDh) të këtyre aktiviteteve, (përmes angazhimit të tyre me anëtarë tjerë të komunitetit të gjerë në aktivitete të përbashkëta, pa e theksuar karakterin PEDh e të njëjtave), dhe

- Rritja e kapaciteteve të autoriteteve lokale për përfshirje shoqërore të grupit të popullatës dhe për mbështetje shoqërore dhe përfshirje në tregun e punës.

Njerëzit e Komunitetit të Synuar (nr.)

Konsorciumi do të punojë me dy Grupe të Popullit:

Grupi Popullit 01:

Të Kthyerit, të Burgosurit dhe Familjet e tyre

Grupi Popullit 02:

Popullata e Përgjithshme Rinore e moshave 15-30 vjeçare

Të Dalat dhe Rezultati(et) e Pritura nga Grupet e Popullit

Grupi i Popullit 01: Të Kthyerit, të Burgosurit dhe Familjet e tyre

Konsorciumi synon të krijoj një ambient të përshtatshëm shoqëror dhe institucional që do të zbus perceptimet e marginalizimit/izolimit dhe padrejtësisë socio-ekonomike, të ndërlidhura me stigmatizimin dhe qeverisjen me paraqitje armiqësore, i cili përfundimisht do ta përforcojë aftësinë rezistuese të Grupit të Popullit ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm dhe do ta zbeh ndikim e grupeve radikale të cilët mund të tentojnë t'i rikthejnë ata tek mënyrat paraprake të jetesës dhe të pengojnë integrimin e tyre përbrenda shoqërisë së gjerë.

Grupi i Popullit 02: Popullata e Përgjithshme Rinore e moshave 15-30 vjeçare

Duke përdorur një qasje gjithëpërfshirëse, Konsorciumi do: t'i jap formë diskursit publik drejt një parandalimi efektiv të ekstremizmit të dhunshëm në mesin e rinisë, të ngritë vetëdijësimin e rinisë dhe të angazhojë lider të ri potencial në PEDh përbrenda komuniteteve të tyre, dhe të ngritë llogaridhënie institucionale dhe angazhimin e komunitetit përmes fuqizimit të rinisë në politikë-bërje të orientuar kah PEDh-ja nga ana e autoriteteve komunale me pjesëmarrjen e komuniteteve rinore, dhe kyçje të studentëve, mësuesve dhe prindërve në nismat për PEDh, të cilat përfundimisht do të përforcojnë aftësitë rezistuese për një parandalim efektiv të ekstremizmit të dhunshëm në mesin e të rinjve.

Shtrirja Kohore e Projektit

Fillon nga 1 Marsi 2018 dhe zgjat deri me 31 Dhjetor 2020.

Lokacioni i Projektit

Rajonet e Prishtinës, Prizrenit, Gjilanit, Ferizajit dhe Mitrovicës

Për pyetje shtesë, ju lutem kontaktoni:

Alketa Bala

Menaxhere e Konsorciumit,

Konsorciumi Me Demokraci Pjesëmarrëse për një Kosovë pa Radikalizim

Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC)

Rr. Gazmend Zajmi, nr. 20, 10000 Prishtinë, Kosovë

Kontakti: +38344152758

E-mail: alketa@advocacy-center.org